



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2303 prot.

Fushë-Arrëz, më 04.08.2025

VENDIM

Nr. 24, datë 30.07.2025

PËR

MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR I BLOK-NDIHMËS EKONOMIKE PREJ 6% PËR MUAJIN QERSHOR 2025 PËR NJËSITË ADMINISTRATIVE : FUSHË-ARRËZ, IBALLE, QAFË-MALI, BLERIM DHE FIERZË.

Në zbatim të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 24, ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë"; VKM nr.597.datë 4.9.2019 "Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe të përdorimit të fondit shtesë, mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", VKM nr.85, datë 10.02.2021 "Për një shtesë në vendimin nr. 597. datë 4.9.2019 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike, dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike"; Udhëzimit të Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë nr. 5, datë 17.2.2017 "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%", i ndryshuar ; VKM nr.868. datë 29.12. 2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr 597. datë 4.9.2019 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe të përdorimit të fondit shtesë mbi fondet e kushtëzuara për ndihmën ekonomike", VKB nr.2, datë 27.01.2025 "Për miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6%", në bazë të dokumentave të sjella me propozimin e kryetarit të Bashkisë, **Këshilli i Bashkisë Fushë-Arrëz në mbledhjen e tij të datës 30.07.2025**, pas shqyrtimit të propozimeve të paraqitura nga administratorët e ndihmës ekonomike të bashkisë Fushë-Arrëz,

VENDOSI

Të miratojë listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok- ndihmës ekonomike deri në 6 % për muajin **Qershor 2025**, 27 familje, me fond **110,712** lekë nga fondi total i ndihmës ekonomike në vlerën **1,845,203** lekë dhe shpërndarë për përfituesit e 6% në shumën **110,160** lekë sipas Njësive Administrative:

NJËSIA ADMINISTRATIVE QENDËR FUSHË-ARRËZ

Përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6% për muajin Qershor 2025, 12 familje me një fond 42,288 lekë.

NJËSIA ADMINISTRATIVE QAFË-MALI

Përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë nga fondi i kushtëzuar i bllok -ndihmës ekonomike prej 6% për muajin Qershor 2025, 4 familje me një fond 13,999 lekë.

NJËSIA ADMINISTRATIVE BLERIM

Përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6% për muajin Qershor 2025, 3 familje me një fond 14,313 lekë.

NJËSIA ADMINISTRATIVE FIERZË

Përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6% për muajin Qershor 2025, 3 familje me një fond 19,424lekë.

NJËSIA ADMINISTRATIVE IBALLE

Përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6% për muajin Qershor 2025, 5 familje me një fond 20,136 lekë.

Bashkëlidhur tabelat e detajuara për çdo Njësi Administrative të bashkisë Fushë-Arrëz.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata e Bashkisë.

Vendimi u miratua nga Këshilli Bashkiak me:

8 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Zbardhur, më ____ . ____ .2025

Ky Vendim hy në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike sipas pikës 6, neni 55 të Ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar.

SEKRETAR

Naze SELIMAJ



KRYETAR

Nikolin BARDHOKU



Adresa: Rruga Qendër, Bashkia Fushë-Arrëz

email: info@bashkiafushearrez.gov.al